MOT' I PARƐ 1 PRIΛ 1909. № 4

# DITURIJA

## E PƐRKOHƐƟME ƟQIP LITERARE БE DITURAKE

**DEL ИƐ HERƐ NƐ MUAJ**

*Dreqtoɳεs:* ʟUMO SKƐNDO

MBAN:

A do tε kemi ɳε tε vetεm guhε literare ɵqip. — Tε vεmε re kur ɵkrojmε: Lumo Skεndo.—Fjalεtore e vogεlε. — Fjalεtoret ɵqip.—Vjoλca δe djali: Sakoli.—Vjerɵε nga libra Valεt e Detit: S. D.—Djeλi.—Ata qε hanε δê.—Pol' i Jugεsε—Andej-Kεtej. — Pjesa ɵtεpiake. — Bibliografi.



SELANIK

# DITURIJA

## A do tε kemi ɳε tε vetεm ɡuhε literare ϭqip?

NƐ mes tε kaqε tε veϭtirave tε tjera kemi ƌe ndarjen e ɡuhεs' sεnε. Sa-do-qε ɡuha εϭtε ɳε ƌ' e vetεmε, s' munt tε mohohetε ndryϭim' i maƌ q' εϭtε nε mes tε dy dialektεvet toskε ƌe gegε, pa numuruarε ƌe nεnε-dialektet e tjerε.

Sot po ϭkrojmε po ƌua nε çdo dialekt ƌe ϭumε herε ɳε librε mbetet e pakupεtuarε pej tε tjerεvet. Pεr ɳε komp tε vogεlε ƌe tε dobεtε si ne, kjo ndarje ƌe çarje εϭtε ɳε e veϭtir' e maƌe, ɳε rezik i vεrtetε, qε s' munt tá ϭikojmε me ɡak tε ftohtε.

Ɛϭtε pra nevoj' e maƌe qε tε kemi pεr ϭqipen tεnε mε tε ϭkruarε ɳε tε vetεm dialekt, ɳε tε vetεm ɡuhε litarare, e cila tε nxihet ƌe tε pεrdoret pej tε tεrε kombit tεnε, si kundrε qε te ɡiƌε kombet e qytetεruarε ɳε tε vetεm dialekt literar kanε.

Cili do tε jetε ky dialekt? A do tε marrim ɳε nga tε dy degat e mbεƌa tε sotme — toskεriϭten a gegεriϭten — a po do tε marrim no ɳε dialekt nε mes tε dyvet?

Ɛϭtε ƌεnε ϭumε herε qε tε miret dialεkt' i Elbasanit si ɳε ɡuh' e pεrmesme ƌ' e kuptuarϭime pej tε ɡiƌε Ϭqipεtarεvet.

Pεr kεtε qελim do tε ϭkruheϭ ƌe tε nxiheϭ dialekt' i Elbasanit — a no ɳε tjatεr atje afεrε — aϭtu si flitet pej popuλit a me pakε ndryϭim. Po na ɳε e veϭtirε tjatrε: kεtε dialekt tε pεrɡiƌϭim kuϭ do tε na e mεsojε? Sot pεr sot as no ɳε veprε tε maƌe kemi nε ɡuhε t' Elbasanit, as no ɳε ϭkroɳεtore kemi qε tε na rrεfejε nε fjeϭtesí tε tyre reguλat e asaj ɡuhe. I vetεmi ϭkroɳεs nga Elbasani, Kristoforiƌi, ka pεrdorur jo dialektin e vendit tε tij, po ɳε ɡuhε tε pεrzjerε. Eƌe pa ɳε veprε tε mirε, pa ɳε uƌεheqεs tε mbaruarε s' munt qε tε mεsohet me ɡiƌε bukurit' e saj ɳε ɡuhε literare.

Pεr tε paturε ɳε zɡiƌje tε kεsaj çεϭtjeje kaqε tε rεndε pεr ne, deϭmε tε dimε ƌe mendimet e ɳerεzet qε kanε bεrε studime mi ɡuhet ƌe